

START WELL (FILLONI MIRË)

Ndryshime të propozuara ndaj shërbimeve të maternitetit, atyre neonatale, si dhe atyre kirurgjikale për fëmijët



Dokument
përmbledhës konsultimi

11 Dhjetor 2023 deri 17 Mars 2024

Përmbajtjet

1	Hyrje	3
1.1	Rreth Sistemit të Përkujdesjes së Integruar të Londrës Qendrore Veriore dhe Bordit të Përkujdesjes së Integruar	3
1.2	Lidhuni.....	3
1.3	Rreth këtij dokumenti.....	4
1.4	Rreth programit “Start Well”.....	4
2	Përkujdesja e maternitetit dhe ajo neonatale	8
2.1	Mundësitë e përmirësimit: arsyet tona për ndryshime.....	8
2.2	Propozimet tona për shërbimet e maternitetit dhe ato neonatale.....	9
3	Shërbimet kirurgjikale për fëmijët	15
3.1	Mundësitë e përmirësimit: arsyet tona për ndryshime.....	15
3.2	Propozimet tona për shërbimet kirurgjikale të emergjencës dhe të planifikuara për fëmijët	16
4	Reagimet ndaj konsultimit	19
4.1	Si t’i shprehni mendimet tuaja.....	19
4.2	Hapat e radhës.....	19

1 Hyrje

1.1 | Rreth Sistemit të Përkujdesjes së Integruar të Londrës Qendrore Veriore dhe Bordit të Përkujdesjes së Integruar

Sistemi i Përkujdesjes së Integruar i Londrës Qendrore Veriore (NCL ICS) bashkon organizatat vendore të shëndetësisë dhe të përkujdesjes, bashkitë, si dhe sektorin vullnetar, komunitar dhe të ndërmarrjeve sociale, që të punojnë në mënyra të koordinuara për të përmirësuar rezultatet shëndetësore për banorët e bashkive londineze Barnet, Camden, Enfield, Haringey dhe Islington, si dhe për të zgjidhur pabarazitë ekzistuese.

Kemi ambicien të bashkëpunojmë me banorët e të gjitha grupmoshave që të mund të gëzojnë fillësën më të mirë në jetë, të jetojnë më shumë vjet me shëndet të mirë fizik dhe mendor në një ambient të qëndrueshëm, të plaken në kuadrin e një komuniteti të lidhur dhe mbështetës, dhe të përjetojnë një vdekje dinjitoze. Ne dëshirojmë edhe t'i mbështesim punëmarrësit e përkujdesjes shëndetësore dhe sociale që të Work Well [Punojnë Mirë]. Këtë ambicie e përmbledhim si: Start Well, Live Well, Work Well, Age Well [Filloni Mirë, Jetoni Mirë, Punoni Mirë, Plakuni Mirë]. Këtë ambicie dëshirojmë ta arrijmë për të gjithë.

Këtë dokument e botoi Bordi i Përkujdesjes së Integruar i Londrës Qendrore Veriore (NCL ICB). ICB-ja është përgjegjëse për zhvillimin e një plani për t'i përmbushur nevojat shëndetësore të popullsisë vendore, duke administruar buxhetin NHS për Sistemin tonë të Përkujdesjes së Integruar, dhe duke siguruar disponimin e shërbimeve shëndetësore në këtë zonë.

Si pjesë e detyrave tona statutores, ne - Bordi i Përkujdesjes së Integruar i Londrës Qendrore Veriore – po bëjmë konsultime lidhur me propozimet tona për të ndryshuar disa shërbime materniteti, neonatale, si dhe kirurgjikale emergjente dhe të planifikuara për fëmijët, në emër të partnerëve të Sistemit të Përkujdesjes së Integruar.

Shërbimet e specializuara, për shembull përkujdesja neonatale dhe disa kirurgji specialiste, porositen nga grupi i specializuar porositës NHS England. Prandaj, NHS England po bën konsultime bashkë me ne lidhur me këto propozime, dhe është angazhuar ngushtë me punën që në fillim.

1.2 | Lidhuni

Shpresojmë se do të lidheni me ne dhe të shprehni mendimet që keni. Ju mund ta bëni këtë në disa mënyra të ndryshme, përfshi:

- Email: StartWellConsultation@ors.org.uk
- Telefon: 0800 324 7005
- Postë: FREEPOST SS1018, PO Box 530, Swansea, SA1 1ZL
- Internet: nclhealthandcare.org.uk/start-well

Nëse dëshironi ta keni këtë dokument në format alternativ, përfshi Braille, audio, Leximin e Lehtë, ose të përkthyer në një gjuhë tjetër, ju lutemi na kontaktoni.

1.3 | Rreth këtij dokumenti

Ky dokument paraqet një përmbledhje të propozimeve tona për ndryshime në shërbimet e maternitetit dhe ato neonatale, si dhe shërbimet kirurgjikale për fëmijët. Mund ta gjeni dokumentin e plotë të konsultimit, si dhe shumë informacione të tjera, te faqja jonë në internet nclhealthandcare.org.uk/start-well, ose duke na kontaktuar me telefon ose email për të kërkuar një kopje të shtypur.

Mund të zgjidhni t'i shprehni mendimet tuaja për të dyja propozimet për përkujdesjen e maternitetit dhe atë neonatale dhe kirurgjisë së fëmijëve, ose për një fushë të vetme.

Pyetjet që ju bëjmë

Ndërsa lexoni këtë dokument, mund t'ju ndihmojë nëse merrni parasysh pyetjet kyç të cilat i bëjmë për këtë konsultim:

- A jeni dakord që NHS ka nevojë të bëjë ndryshime që t'u përgjigjen sfidave në këto shërbime?
- Deri në ç'masë jeni apo nuk jeni dakord me propozimet që i përshkruajmë?
- Cilat mendoni se janë anët negative kryesore, dhe çfarë mund të bëjmë për t'iu drejtuar atyre?
- A ka opsione të tjera të cilat duhet t'i marrim parasysh para se të marrim një vendim?



START WELL

1.4 | Rreth programit "Start Well"

Ambicia jonë është të ofrojmë shërbime të cilat mbështesin fillimin më të mirë të jetës, si për banorët tanë ashtu dhe për njerëz nga bashkitë fqinje dhe më larg të cilët zgjedhin t'i përdorin shërbimet tona.

Për këtë arsye, në Nëntor 2021, organizatat partnere të cilat përbëjnë Sistemin e Përkujdesjes së Integruar të Londrës Qendrore Veriore nisën formalisht një program afatgjatë për të rishikuar dhe përmirësuar shërbimet e maternitetit, ato neonatale si dhe ato për fëmijët dhe të rinjtë. Një synim kyç i programit është ndihmë për t'iu drejtuar pabarazive shëndetësore që i shohim midis komuniteteve të zonës sonë.

Nevojat vendore shëndetësore dhe të përkujdesjes: Materniteti, ato neonatale, fëmijët dhe të rinjtë

Numri i foshnjave të lindura në Londrën Qendrore Veriore **ka qenë në rënie e sipër.**

Rreth 20.000 foshnja lindën nga Prill 2021 deri Mars 2022, rreth 1.000 më pak krahasuar me vitin 2018.

Numri i fëmijëve dhe të rinjve të cilët banojnë në Londrën Qendrore Veriore parashikohet se do të bjerë. Rreth 21% e 1,8 milionë banorëve tanë janë fëmijë dhe të rinj, të përkufizuar si ata të grupmoshës 0-18. Brenda vitit 2041, popullsia parashikohet të ulet me 10%.

Gratë dhe njerëzit aziatikë shtatzënë kanë më shumë se dy herë mundësinë për t'u bërë me diabet gjatë shtatzënisë, krahasuar me gratë dhe njerëzit e bardhë shtatzënë (21% kundrejt 9%). Diferenca të ngjashme shihen edhe për gjendje të tjera afatgjata gjatë shtatzënisë.

Janë veçanërisht të llojlojshëm fëmijët dhe të rinjtë të cilët banojnë në Londrën Qendrore Veriore. Pak më shumë se një çerek i fëmijëve dhe të rinjve në këtë zonë cilësojnë veten si britanikë të bardhë, një çerek si të tjerë të bardhë, dhe 10% si afrikanë të zinj. Më shumë se 150 gjuhë fliten nga fëmijët e Londrës Qendrore Veriore dhe 20% prej tyre nuk flasin anglisht si gjuha e parë e familjes së tyre.

Midis viteve 2018 dhe 2020, ka patur mbi **tri herë numrin e lindjeve në zonat më të varfra të Londrës Qendrore Veriore,** krahasuar me zonat më pak të varfëruara.




Vlerësohet se **një nga pesë fëmijët dhe të rinjtë nën moshën 16 vjeç po jeton në varfëri.** Ekziston një lidhje midis varfërisë së të ardhurave dhe etnicitetit në Londrën Qendrore Veriore, ku fëmijët nga disa etnicitete janë më të varfër mesatarisht sesa të tjerët. **Fëmijët dhe të rinjtë me etnicitet të zi janë në përgjithësi më të varfër sesa komunitetet e tjera,** meqë mbi 80% e fëmijëve afrikanë të zinj dhe afrikanë karaibesh banojnë në zonat më të varfra të Londrës Qendrore Veriore.



Shërbimet tona aktuale

Shërbimet e maternitetit dhe ato neonatale në Londrën Qendrore Veriore



- Repart materniteti i udhëhequr nga obstetrika
- Repart materniteti i udhëhequr nga mamitë
- Repart i pavarur i udhëhequr nga mamitë
- Shërbimi i lindjeve në shtëpi
- Niveli 1 - Repart neonatal i përkujdesjes së veçantë
- Niveli 2 - Repart neonatal vendor
- Niveli 3 – repart neonatal i përkujdesjes intensive (kirurgjikale dhe tretësore)
- Qendër shumë e specializuar për gratë dhe njerëzit shtatzënë dhe foshnjat e tyre, para dhe pas lindjes

Shërbimet spitalore për fëmijët dhe të rinjtë në Londrën Qendrore Veriore




Figura 1: hartë e shërbimeve spitalore të maternitetit, atyre neonatale dhe të fëmijëve dhe të rinjve në Londrën Qendrore Veriore

2 Përkujdesja e maternitetit dhe ajo neonatale

Kjo pjesë përqëndrohet në propozimet tona për ndryshime në shërbimet e maternitetit dhe ato neonatale në Londrën Qendrore Veriore.

Ju mund të gjeni shumë hollësi të tjera për propozimet dhe mënyrën se si u zhvilluan, në faqen tonë të internetit nclhealthandcare.org.uk/start-well

2.1 | Mundësitë për përmirësim: arsyet tona për ndryshime

Ne besojmë që kemi arsye bindëse për ndryshimet që i propozojmë për shërbimet. Është e rëndësishme të njohim faktin që ka shumë zona në Londrën Qendrore Veriore me përkujdesje të shkëlqyer, dhe e dimë që punonjësit tanë punojnë shumë dhe janë të përkushtuar për të arritur rezultatet më të mira të mundshme për pacientët. Ekzistojnë mundësi që ne ta përmirësojmë cilësinë e shërbimeve dhe rezultateve për banorët vendorë, t'u drejtohem fushave me pabarazi, dhe t'u ofrojmë një eksperiencë më të mirë pacientëve tanë, familjeve të tyre, kujdestarëve, dhe punonjësve tanë. Disa nga sfidat dhe mundësitë përfshijnë:

- Nevojat e banorëve vendorë po ndryshojnë, dhe shërbimet tona duhet t'i përshtaten rënies së lindjeve të foshnjave si dhe faktit që përkujdesja e nevojitur gjatë shtatzënisë dhe pas lindjes po bëhet gjithnjë e më e ndërlikuar.
- Shërbimet tona nuk janë të përgatitura aktualisht për të përmbushur nevojat e gjithsecilit i cili i përdor, dhe kjo mund të ndikojë në cilësinë e tyre.
- Përdorimi i pakët i përkujdesjes së udhëhequr nga mamitë është veçanërisht i mprehtë te Qendra e Lindjeve Edgware. Mesatarisht, më pak se 50 gra dhe njerëz shtatzënë (më pak se një për javë) lindën atje gjatë secilit nga tre vitet e fundit.
- Ne duhet të sigurohem që ka mjaft përkujdesje neonatale në vendet e duhura. Repartet tona neonatale në University College London Hospitals NHS Foundation Trust (UCLH) dhe në Great Ormond Street Hospital for Children NHS Foundation Trust (GOSH), të cilat kujdesen për foshnjat e lindura më parakohshëm dhe më të sëmura, janë shpesh të plota, kështu që foshnjat nganjëherë transferohen në reparte më larg shtëpisë. Nga ana tjetër, gjysma e djepave të reparti neonatal në Royal Free Hospital, i cili kujdeset për foshnjat më të shëndetshme, nuk përdoren në ndonjë ditë të caktuar.
- Duam që gjithkush i cili përdor shërbimet tona ta gëzojë ambientin më të mirë spitalor. Për shembull, dhomat e lindjeve me banjo të bashkangjitura si dhe repartet neonatale me mjaft hapësira që prindërit të kalojnë kohë të kënaqshme me foshnjat e veta. Këto i ofrojnë disa spitale, ndërsa të tjerat jo.
- Ne duhet të përballemi me sfidat e personelit që na dalin përpara. Ka aktualisht shumë vende pune bosh në profesionin e mamisë, në infermierin neonatale, si dhe në profesione të tjera shëndetësore të cilat merren me përkujdesjen e foshnjave. Mungesa e personelit të duhur ndikon disa herë në cilësinë e përkujdesjes që jemi në gjendjen ta ofrojmë. Për shembull, kjo do të thotë nganjëherë që na duhet t'i mbyllim repartet e udhëhequra nga mamitë, gjë që prek zgjedhjen në dispozicion.

Ne u kërkuam njerëzve të shprehnin mendimet e veta lidhur me arsyet tona për ndryshime, si dhe për hapësirat që kemi gjetur për të bërë përmirësime. Zbulimet kryesore nga ato që njerëzit na treguan se janë të rëndësishme për ta janë sa vijon:

- Përkujdesja e maternitetit: e sigurt dhe e dhembshur, me komunikime të efektshme
- Përkujdesja neonatale: shërbimet më të mira të mundshme të përcjella nga specialistët, me komunikime të efektshme

Ju mund të lexoni më shumë për arsyet tona për ndryshime si dhe veprimtarinë e angazhimit që zbatuam, te faqja jonë në internet: nclhealthandcare.org.uk/start-well

2.2 | Propozimet tona për shërbimet e maternitetit dhe ato neonatale

Përkujdesja neonatale

Propozimi ynë për të ardhmen është që të kemi gjithsej katër reparte neonatale, krahasuar me pesë sot. Njëri prej këtyre do të ishte repart i nivelit 3, i cili kujdeset për foshnjat e lindura më parakohshëm ose më të sëmurat, me tri reparte të tjera të nivelit 2. Këto reparte do të kishin mundësi të kujdeseshin edhe për foshnjat me nevoja më pak të ndërlikuara.

Nuk propozojmë asnjë ndryshim për repartin neonatal te Great Ormond Street Hospital sepse ky është repart specialist i cili i shërben të gjithë vendit.

Niveli 1: Repart i përkujdesjes së veçantë		Niveli 2: Repart i vendor neonatal		Niveli 3: Reparti i përkujdesjes intensive neonatale	
Përkujdesja për foshnjat me gjendjet më pak të ndërlikuara		Shkallëzimi i radhës i përkujdesjes		Përkujdesje për foshnjat e lindura më parakohshëm ose më të sëmurat	
Numri sot	Në të ardhmen	Numri sot	Në të ardhmen	Numri sot	Në të ardhmen
1	0	3	3	1	1

Pse propozojmë këto ndryshime?

Besojmë që ndryshimet që i propozojmë do të na ndihmonim të:

- sigurojmë përdorimin më të barabartë të reparteve, me qëllim që punonjësit të shohin mjaft foshnja për të mirëmbajtur aftësitë, gjë e cila nga ana e saj ndihmon në përmirësimin e cilësisë së përkujdesjes që ofrojmë
- ulim numrin e foshnjave të transferuara në një spital tjetër (nganjëherë jashtë Londrës Qendrore Veriore) për të marrë përkujdesjen që u duhet
- shfrytëzojmë më së miri numrin e kufizuar të personelit të specializuar në dispozicionin tonë.

Përkujdesja e maternitetit

Ndryshimi kryesor që propozojmë për shërbimet e maternitetit lidhet me numrin dhe llojin e reparteve të lindjeve që kemi. Sipas propozimit tonë për shërbimet e maternitetit, gratë dhe njerëzit shtatzënë do të kishin akoma zgjedhjen e tri vendndodhjeve për lindjet: repartet obstetrike (të udhëhequra nga mjekët specialistë) të lindjeve, repartet 'shoqëruese' të udhëhequra nga mamitë, ose lindjet në shtëpi.

Propozojmë katër reparte lindjesh të udhëhequra nga obstetrika, secili me nga një 'shoqëruese' të udhëhequr nga mamitë, në vend të pesë reparteve aktuale. Shërbimet bashkiake të lindjeve në shtëpi do të vazhdonin nëpër Londrën Qendrore Veriore.

Nëse do të realizoheshin, propozimet tona do të thonë që shërbimet në një ambient spitalor do të mbylleshin. Ne konsultohemi lidhur me dy opsione për të cilat spitali nuk do të ofronte më përkujdesje materniteti dhe neonatale.

Propozojmë edhe që të mos jetë më asnjë repart i pavarur i udhëhequr nga mamitë, kështu që dhomat e lindjes tek Edgware Birth Centre do të mbylleshin. Ky vendim nuk varet nga propozimi për të mbyllor shërbimet e maternitetit dhe ato neonatale të njërit nga spitalet tona.

Repart lindjesh i udhëhequr nga obstetrika	Repart lindjesh shoqërues i udhëhequr nga mamitë	Grupet e lindjeve në shtëpi (të cilat mbulojnë të gjithë Londrën Qendrore Veriore)	Repart i pavarur i lindjes i udhëhequr nga mamitë	
Një repart lindjesh i drejtuar nga mjekët e specializuar për shtatzëninë dhe procesin e lindjes	Një repart lindjesh i drejtuar nga mamitë, i ndodhur në të njëjtin vend me repartin obstetrik	Përkujdesja nga mamitë gjatë procesit të lindjeve në shtëpinë e gruas ose personit shtatzënë	Një repart lindjesh i udhëhequr nga mamitë, i cili nuk ndodhet në të njëjtin vend me repartin obstetrik	
T'i bashkojmë shërbimet neonatale dhe të maternitetit në katër spitale dhe jo pesë siç janë sot			Numri sot	Në të ardhmen
			1	0

Pse propozojmë këto ndryshime?

Ne propozojmë këto ndryshime për repartet e maternitetit sepse:

- ato nënkuptojnë që të gjitha repartet obstetrike dhe ato të udhëhequra nga mamitë mund të ndodhen pranë një reparti të përkujdesjes neonatale të nivelit 2 ose 3 për të ulur numrin e foshnjave të transferuara në spitale të ndryshme pas lindjes
- ato do të an ndihmonin të shfrytëzonim më së miri personelin tonë të kualifikuar
- në Edgware Birth Centre nuk lindin mjaft fëmijë për ta vazhduar në planin afatgjatë

Ashtu si sot, gratë dhe njerëzit shtatzënë do të vazhdonin të aksesonin një gamë të gjerë përkujdesje dhe mbështetje rutinë dhe, atje ku nevojitet, specialiste, antenatale dhe pas lindjes gjatë kohës që tentojnë të bëhen me barrë, gjatë shtatzënisë dhe pas lindjes.

Pse nuk mund ta rrisni numrin e lindjeve në Edgware Birth Centre?

Evidentohet që repartet e pavarura të lindjeve janë më të sigurta për gratë dhe njerëzit shtatzënia e të cilëve vlerësohet si me rrezik të ulët. Nga rishikimi i të gjitha lindjeve në Londrën Qendrore Veriore në vitet 2021/22, rezulton se rreth 70% e lindjeve në Londrën Qendrore Veriore cilësohen të kenë rrezik të mesëm deri të lartë, dhe nga shifra 30%, një numër akoma më i vogël do të ndodheshin brenda një distance të shkurtër të repartit. Kjo do të thotë se është relativisht i vogël grupi i grave dhe njerëzve shtatzënë të cilët cilësohen të përshtatshëm për të lindur në Edgware, nëse zgjedhin këtë. Nga kjo pjesë grash dhe njerëzish shtatzënë, një numër akoma më i vogël do të gjendeshin brenda një distance të shkurtër të repartit. Duke marrë parasysh rënien e normës së lindjeve si dhe numrin në rritje të shtatzënive me rrezik të mesëm deri të lartë, nuk ka shumë të ngjarë që do të ishim në gjendje të rrisim numrin e lindjeve në Edgware.

Mënyra se si zhvilluam opsionet për konsultim

Procesi i zhvillimit të opsioneve për konsultim u udhëheq nga mjekët dhe infermieret eprore dhe përfshiu pacientët dhe përfaqësuesit e tyre. Ne morëm parasysh edhe reagime të cilat dëgjuam lidhur me arsyet për ndryshime, si dhe më gjerësisht lidhur me shërbimet e maternitetit dhe ato neonatale.

Ne shikuar kombinimet e ndryshme të mundshme të opsioneve për vendndodhjen e katër reparteve të propozuara neonatale dhe të lindjeve. Secili kombinim përfshinte UCLH si ambientin e një reparti neonatal të përkujdesjes intensive të nivelit 3 sepse do të ishte shumë e vështirë ta lëvizim këtë repart meqë ndodhet bashkë me shërbime të tjera të specializuara për të mbështetur përkujdesjen e foshnjave të lindura shumë parakohshëm dhe të sëmurave, si dhe për shkak të organizimeve në vend për t'u kujdesur për fëmijët jashtë Londrës Qendrore Veriore.

Ne vlerësuam pikat e forta dhe të dobëta të secilit opcioni krahasuar me kriteret sa vijon:

- cilësia e përkujdesjes
- krahu i punës
- aksesimi ndaj përkujdesjes
- përballueshmëria dhe vlera ekonomike.



Opcionet e konsultimit

Ka dy opsione konsultimi për përkujdesjen neonatale dhe të maternitetit:




Figura 2: propozimet e maternitetit dhe neonatale për konsultim

Ndonëse të dyja opcionet mund të realizoheshin, ne preferojmë opcionin A sepse mendojmë që në fund të fundit ka më shumë avantazhe sesa ç'ka opcioni B. Në përmbledhje, preferojmë opcionin A sepse:

- Do të zbatohet më lehtë nga këndvështrimi i personelit sepse nuk do të kërkonte shpërnguljen e asnjë konsulenti neonatal, dhe më pak mami dhe infermiere do të duheshin të lëviznin midis reparteve
- do t'u bënte mirë edhe grave dhe njerëzve në Londrën Qendrore Veriore të cilët lindin aktualisht jashtë reparteve të kësaj zone, sa i përket vazhdimësisë së përkujdesjes dhe integritit të rrugëve akute dhe komunitare.
- opcioni B nënkupton që disa njerëzve do t'u duhej të shkonin në spitale të Londrës Qendrore Veriore të cilat do të kishin vështirësi në këtë për shkak të rritjes së normave të lindjeve në disa pjesë të Londrës Qendrore Veriore
- ndërsa opcioni A nënkupton që disa njerëzve do t'u duhej të shkonin në spitale në Londrën Qendrore Veriore, këto spitale kanë vërtetuar që kanë vend për këtë sepse po bie numri i lindjeve në Londrën Qendrore Veriore.

Pasqyra në faqen 14 përshkruan më me hollësi avantazhet dhe disavantazhet e opsioneve, duke paraqitur ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre.

Ja se si shqyrtoam ndikimin e mbylljes së propozuar të dhomave të lindjeve në Edgware Birth Centre

Ne kemi marrë parasysh me kujdes ndikimin e mbylljes së propozuar të dhomave të lindjeve në Edgware Birth Centre. Ky propozim do të nënkuptonte që më pak se 50 gra dhe njerëz shtatzënë në vit nuk do të kishin më mundësi të lindnin në Edgware. Ne do të vazhdonim të ofronim zgjedhjen e përkujdesjes cilësore të udhëhequr nga mamitë nëpërmjet reparteve shoqëruese të udhëhequra nga mamitë si dhe lindjeve shtëpiake.

Meqë një numër shumë i vogël grash dhe njerëzish shtatzënë lindin te qendra çdo vit, dhe meqë do të kishin opcionin e një lindjeje në shtëpi, propozimet kanë shumë pak mundësi të ndikojnë në akses ose në pabarazitë.

Evidentohet që nuk ka ndryshime domethënëse të rezultateve për foshnjat të cilat lindin në një repart shoqërues ose të pavarur të udhëhequr nga mamitë. Ngaqë do të vazhdonim të ofrojmë zgjedhjen e një reparti shoqërues të udhëhequr nga mamitë, gratë dhe njerëzit shtatzënë prapë do të kishin akses ndaj përfitimeve të përkujdesjes së udhëhequr nga mamitë.

Njohim faktin që disa njerëz nuk do të jenë dakord me mbylljen e propozuar të Edgware Birth Centre, dhe kemi dëshirë të dëgjojmë nëpërmjet konsultimit për ndikimin e mundshëm të këtij propozimi, mënyra për të ulur çfarëdolloj ndikimi negativ, si dhe zgjidhje ose mundësira potenciale të cilat besoni se mund të mos i kemi marrë parasysh.

Vendimi lidhur me mbylljen e Edgware Birth Centre varet nga vendimi për propozime të tjera për përkujdesjen e maternitetit dhe atë neonatale me bazë te spitalet.

Përmbledhje e ndikimit të propozimeve tona

Përmbledhje e ndikimit të propozimeve tona

- ofronim përkujdesjen para dhe pas lindjes sa më afër shtëpisë, duke siguruar që të gjithë të kenë akses për të njëjtat shërbime dhe informacione
- vazhdonim të ofronim opcionin e lindjeve në shtëpi nëpër Londrën Qendrore Veriore
- kishim reparte lindjesh të udhëhequra nga obstetrika dhe nga mamitë te UCLH, Barnet Hospital dhe North Mid
- siguronim një mjedis i cili do të garantonte privaci dhe dinjitet për gratë dhe njerëzit shtatzënë të cilët lindin
- kishim akses të barabartë ndaj përkujdesjes neonatale jashtë spitalit duke zbatuar një shërbim 'repart virtual' i cili lejon monitorizimin e foshnjave në shtëpinë e vet nga specialistët neonatalë
- kishim një repart neonatal të përkujdesjes intensive të nivelit 3 te UCLH, i cili mund të përballet me kërkesat
- ofronim reparte vendore cilësore neonatale të nivelit 2 te spitalet Barnet dhe North Middlesex, si dhe te një spital tjetër në Londrën Qendrore Veriore
- merrnim parasysh me kujdes se si ta ulim ndikimin e ndryshimeve të shërbimeve te popullata të cenushme, sidomos lidhur me aksesin ndaj teknologjisë dixhitale dhe makinave, lehtësinë e aksesit ndaj ambienteve spitalore, si dhe pengesat kulturore dhe gjuhësore.

Ndikimet Specifike të Opcionit A

- Infermieret dhe mamitë neonatale të cilat punojnë aktualisht te Royal Free Hospital do të mbështeteshin që të transferoheshin në spitale të tjera të Londrës Qendrore Veriore ku ka vende pune
- Rritja e kohëve mesatare të udhëtimeve për në spital me makinë, ambulancë dhe taksì, prej rreth katër-pesë minutash
- Rritja e kohëve mesatare të udhëtimeve me transport publik prej rreth gjashtë minutash
- Rritja mesatare e kostove të taksive prej £4.90 për udhëtim (rritja maksimale është £11)
- 385 më shumë pacientë në vit do të shkonin në St Mary's Hospital në Paddington, dhe 465 në Northwick Park Hospital në Harrow, në vend të një spitali në Londrën Qendrore Veriore
- Investimi prej rreth £42,4m në ndërtesat e spitaleve tona, veçanërisht për të modernizuar ndërtesat e shek. XIX te Whittington Hospital.

Ndikimet Specifike të Opcionit B

- Reparti neonatal i nivelit 1 te Royal Free Hospital do të përmirësohej në një repart të nivelit 2
- Infermieret neonatale, konsulentët neonatalë, si dhe mamitë të cilat punojnë aktualisht në Whittington Hospital do të mbështeteshin për t'u transferuar në spitale të tjera të Londrës Qendrore Veriore, ku ka vende pune
- Rritja e kohëve mesatare të udhëtimit në spital me makinë, ambulancë dhe taksì prej rreth pesë-gjashtë minutash
- Rritja e kohëve mesatare të udhëtimeve me transport publik prej rreth shtatë minutash
- Rritja mesatare e kostove të taksive prej £4.43 për udhëtim (rritja maksimale është £10)
- 322 më shumë pacientë në vit do të shkonin në Homerton Hospital në Hackney në vend të një spitali në Londrën Qendrore Veriore
- Investimi prej rreth £39,4m në ndërtesat e spitaleve tona për të përmirësuar mjedisin për gratë dhe njerëzit shtatzënë, foshnjat dhe familjet.

3 Shërbimet kirurgjikale për fëmijët

Kjo pjesë e dokumentit të konsultimit përqëndrohet në propozimet tona për ndryshime në shërbimet kirurgjikale për fëmijët në Londrën Qendrore Veriore.

Ju mund të gjeni shumë hollësi të tjera për propozimet dhe mënyrën se si u zhvilluan, në faqen tonë të internetit nclhealthandcare.org.uk/start-well

3.1 | Mundësitë e përmirësimit: Arsyet tona për ndryshime

Me gjithë fushat e shumta me përkujdesje të shkëlqyer nëpër Londrën Qendrore Veriore si dhe punën e madhe të stafit tonë të përkushtuar, ne përballemi me sfida lidhur me shërbimet kirurgjikale për fëmijët. Ka hapësira që ne ta përmirësojmë cilësinë e shërbimeve dhe rezultatet për banorët vendorë, t'u drejtohem fushave me diferenca, si dhe të ofrojmë një eksperiencë më të mirë për pacientët tanë, familjet e tyre, kujdestarët dhe stafin tonë. Disa nga sfidat dhe hapësitat janë sa vijon:

- Shërbimet për kirurgjinë emergjente janë të lëkundshme dhe të paqarta. Punonjësit shpesh kalojnë shumë kohë duke kontaktuar spitale të ndryshme për të gjetur një i cili mund të kryejë kirurgjinë e duhur për fëmijën, dhe disa fëmijë nganjëherë transferohen shumë herë para se të arrijnë në vendin e duhur
- Ekzistojnë sfida të veçanta lidhur me sigurimin e kirurgjisë emergjente për fëmijët shumë të vegjël, nën moshën pesë vjeç. Nuk disponojmë të njëjtat lloje dhe numrin e specialistëve të cilët janë në gjendje të operojnë për fëmijët shumë të vegjël në secilin nga spitalet tona
- Ne duhet të shfrytëzojmë më së miri shërbimet specialiste pranë Great Ormond Street Hospital (GOSH). Kemi zbuluar që fëmijët dhe të rinjtë mbi moshën pesë vjeç po transferohen në GOSH për kirurgji të cilat mund të ishin realizuar në spitalin afër tyre, duke u vënë kështu më shumë presion shërbimeve të GOSH
- Na duhet t'i ulim kohët e pritjes për kirurgjinë e planifikuar. Ka rreth 5.000 fëmijë dhe të rinj në Londrën Qendrore Veriore të cilat presin një operacion të planizuar, dhe lista e pritjes sa vjen edhe zgjatet
- Disa spitale shohin një numër shumë të vogël fëmijësh për specializime të caktuara. Kjo e bën të vështirë që stafi të mësojë dhe të ushtrorë aftësitë e specializuara të cilat nevojiten për kirurgjinë e fëmijëve.

Ne u kërkuam njerëzve të shprehin mendimet e tyre për arsyet tona për ndryshim si dhe mundësitë e përmirësimit që kemi përcaktuar. Zbulimet kryesore nga ato që na treguan njerëzit se janë të rëndësishme për ta, janë:

- Përkujdesja emergjente për fëmijët dhe të rinjtë: përkujdesja afër shtëpisë, pritja e shkurtër si dhe komunikimet e efektshme
- Përkujdesja e planifikuar për fëmijët dhe të rinjtë: të gëzojnë përkujdesjen më të mirë qoftë edhe nëse kjo bëhet më larg shtëpisë, si dhe komunikimet e efektshme

Ju mund të lexoni më shumë për arsyet tona për ndryshime si dhe veprimtarinë e angazhimit që zbatuam, te faqja jonë në internet: nclhealthandcare.org.uk/start-well

3.2 | Propozimet tona për shërbimet kirurgjikale të emergjencës dhe të planifikuara për foshnjat dhe fëmijët më të vegjël

Propozojmë të zhvillojmë dy 'qendra eksperte' të reja, njëra për të ofruar kirurgjinë ambulatorë të rastit dhe njëra për të ofruar kirurgjinë e emergjencës për foshnjat dhe fëmijët më të vegjël si dhe kirurgjinë ambulatorë të planifikuar.

Të dyja qendrat eksperte do të projektoheshin posaçmërisht për t'i plotësuar nevojat e fëmijëve, dhe do të kishin punonjës të specializuar të përkushtuar, duke ndihmuar t'i ulin anulimet dhe të përmirësonin prodhimtarinë.

Spitalet vendore do të vazhdonin të ofronin kirurgjinë emergjente si dhe lloje të zakonshme kirurgjie ambulatorë të rastit për fëmijët më të vegjël. Ashtu si sot, kirurgjia shumë e specializuar për foshnjat shumë të vogla, si dhe për operimet shumë të ndërlikuara, do të ofroheshin te reparte specialiste nëpër Londrën.

Pse propozojmë këto ndryshime?

Afrimi i kirurgjisë emergjente në një ambient të vetëm do të na ndihmonte të vendosim rrugë shumë më të qarta trajtuesh, duke e bërë më të lehtë që punonjësit tanë ta dinë se ku duhet transferuar një fëmijë, dhe duke përsheptuar akses ndaj përkujdesjes emergjente. Furnizimi i operimeve më të ndërlikuara të cilat kërkojnë që pacientët të rrijnë natën në të njëjtin ambient, do të na ndihmonte të shfrytëzohim më së miri krahun e kufizuar të punës të specializuar.

Bashkimi i llojeve më pak të zakonshme të kirurgjisë ambulatorë të rastit për fëmijët dhe foshnjat në një ambient të vetëm do të na ndihmonte edhe të shfrytëzohim më mirë punonjësit tanë të specializuar, duke i ndihmuar të mirëmbajnë aftësitë e tyre. Madje do të ulte mundësinë e anulimit të operimeve meqë punonjësit duhen të merren me emergjencat.

Figura 3: opcioni për konsultim i kirurgjisë së fëmijëve dhe të rinjve



Ja se si zhvilluam opcionin për konsultim

Procesi i zhvillimit të opcionit për konsultim u udhëheq nga mjekët dhe infermieret eprore dhe përfshiu pacientë dhe përfaqësuesit e tyre. Ne morëm parasysh edhe reagime të cilat dëgjuam lidhur me arsyet për ndryshime, si dhe më gjerësisht lidhur me shërbimet kirurgjikale për fëmijët.

Nxorëm përfundimin që i vetmi opcion i mundshëm për qendrën eksperte të propozuar për kirurgjitë emergjente dhe ambulatore të planifikuara, do të ishte Great Ormond Street Hospital (GOSH) sepse:

- në qoftë se qendra eksperte do të ndodhej në ndonjë vend tjetër, do të na duhej të rekrutonim një numër të madh punonjësish shtesë me specializim kirurgjikal që ta drejtojmë qendrën
- aktualisht, shumica e kirurgjive emergjente për fëmijët nën moshën tre vjeç, si dhe shumica e kirurgjive ambulatore të planifikuara, kryhet tashmë te GOSH.

Ne përdorëm kriteret e mëposhtme për të vlerësuar opsionet e mundshme për vendndodhjen e qendrës eksperte të propozuar për kirurgjinë ambulatore të planifikuar:

- cilësia e përkujdesjes
- krahu i punës
- aksesin ndaj përkujdesjes
- përballueshmëria dhe vlera ekonomike.

Pasi zbatuam kriteret e vlerësimit, nxorëm përfundimin që UCLH do të ishte i vetmi vend i mundshëm për qendrën eksperte të propozuar për kirurgjinë ambulatore të rastit, sepse:

- ai është i vetmi spital i cili ka në vend aktualisht anestetistë pediatrikë konsulentë të cilët mund t'u ofrojnë përkujdesje fëmijëve të moshës një deri dy vjeç
- UCLH kryen tashmë rreth dy të tretat e operimeve aktuale ambulatore të rastit për fëmijët dhe të rinjtë në Londrën Qendrore Veriore.

Në faqen tonë të internetit mund të gjeni pasqyra të hollësishme të cilat tregojnë se ku lloje të ndryshme kirurgjie do të ofroheshin për kirurgjitë emergjente, të planifikuara dhe ambulatore të rastit sipas propozimeve tona.



Qendër eksperte për kirurgjinë ambulatore pranë UCLH

- Të gjitha kirurgjitë ambulatore për fëmijët e grupmoshës 1-2
- Llojet më të pazakonta të kirurgjisë ambulatore për fëmijët e grupmoshës 3+
- Synohet të plotësohen nevojat e veçanta të fëmijëve
- Grup kirurgjikal i specializuar i përkushtuar për fëmijët



Repartet e specializuara

- Kirurgjia shumë e specializuar dhe kirurgjia për fëmijët me nevoja mjekësore të ndërlikuara pranë GOSH
- Kirurgjia emergjente e syve pranë Moorfields
- Kirurgjia ortopedike ambulatore e planifikuara pranë RNOH
- Kirurgjia plastike për fëmijët e grupmoshës 3+ pranë Royal Free
- Repartet e traumës pranë St Mary's dhe The Royal London

Takimet ambulatore pranë reparteve vendore, ose në mënyrë virtuale për të ofruar sa më shumë përkujdesje afër shtëpisë

Përmbledhja e ndikimit të propozimit tonë

Propozimi ynë do të na lejonte të:

- sigurojmë që fëmijët dhe të rinjtë të marrin sa më parë kirurgjinë që u duhet
- ofrojmë shumicën e kirurgjive emergjente për fëmijët mbi moshën 5 vjeç pranë spitalit afër tyre
- trajtojmë fëmijët më të vegjël dhe rastet më të ndërlikuara në qendra eksperte me grupe kirurgjikale të përkushtuara për fëmijët
- ofrojmë një qendër eksperte të përkushtuar për kirurgjitë ambulatorë të rastit, duke na ndihmuar të mbrojmë kapacitetin për këtë dhe të ulim anulimet
- përcaktojmë sisteme dhe procese të qarta për kirurgjinë emergjente me qëllim që të gjithë punonjësit ta dinë se ku fëmijët duhet të trajtohen, duke përsheptuar kështu përkujdesjen
- ulim numrin e fëmijëve të transferuar në reparte të ndryshme, si dhe kohën që duhet për t'i transferuar, duke ndihmuar kështu në uljen e stresit për stafin, pacientët dhe prindërit, dhe duke ulur rrezikun se fëmijët do të sëmuren më keq
- shfrytëzojmë më së miri grupet tona kirurgjikale të specializuara për fëmijët, duke i konsoliduar në më pak ambiente, duke bërë përkujdesjen më efikase dhe duke siguruar që fëmijët të trajtohen nga specialistët, sidomos për procedurat kirurgjikale të planifikuara më të pazakonta
- ndihmojmë punonjësit tanë të mësojnë, ndërtojnë dhe mirëmbajnë aftësitë që kanë, duke trajtuar më shumë pacientë, për shkak të konsolidimit të shërbimeve në më pak ambiente
- trajtojmë fëmijët në mjedise të projektuara posaçmërisht, përfshi sallat e operacionit dhe vendet e rimëkëmbjes të cilat janë miqësore për fëmijët, nga ana e punonjësve me përgatitje specifike për t'u kujdesur për fëmijët, duke ndihmuar në përmirësimin e përvojës së tyre të përkujdesjes.

Ndikimi specifik i ndryshimeve të kirurgjisë emergjente dhe asaj ambulatorë të planifikuar

- Rreth 300 fëmijë në vit do të operoheshin në një vend tjetër nga ç'ka sot (më pak se 10% e të gjitha kirurgjive të fëmijëve dhe të rinjve)
- Rritja e kohëve mesatare të udhëtimit për në spital prej rreth 30 minuta me makinë dhe taksì, dhe 18 minuta me transport publik
- Rritja mesatare e kostove të taksive prej £22 për çdo udhëtim
- Rritja totale prej 327kg e karbonit si pasojë e kohëve të shtuara të udhëtimeve
- Investimi prej £3,7m për të rritur kapacitetin dhe numrin e krevateve pranë GOSH.

Ndikimi specifik i ndryshimeve të kirurgjisë ambulatorë të rastit

- Rreth 300 fëmijë në vit do të operoheshin në një vend tjetër nga ç'ka sot (më pak se 10% e të gjitha kirurgjive të fëmijëve dhe të rinjve)
- Rritja e kohëve mesatare të udhëtimit për në spital prej rreth 27 minuta me makinë dhe taksì, dhe 13 minuta me transport publik
- Rritja mesatare e kostove të taksive prej £22 për çdo udhëtim
- Rritja totale prej 298kg e karbonit si pasojë e kohëve të shtuara të udhëtimeve
- Investimi prej £50.000 për të rritur kapacitetin dhe numrin e krevateve pranë UCLH.

4 Si t'i përgjigjeni konsultimit

4.1 | Si t'i shprehni mendimet tuaja

Dëshirojmë ta dimë se si mendoni për propozimet tona para se të vendosim se si të ecim përpara. Konsultimi ynë zgjatet për 14 javë, nga 11 Dhjetor 2023 deri në mesnatë të dt. 17 Mars 2024.

Është shumë e rëndësishme për procesin tonë të vendimmarrjes që ne të jemi plotësisht të dijshtëm për mendimet e banorëve vendorë dhe të atyre të cilët përdorin shërbimet tona, që të kemi dëgjuar për opsione alternative të mundshme të cilat njerëzit duan që t'i marrim parasysh, si dhe që kuptojmë çdo shqetësim dhe idetë e njerëzve se si mund t'u drejtohem shqetësimeve.

Ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit [ncihealthandcare.org.uk/start-well](https://www.ncihealthandcare.org.uk/start-well), na thirri me nr. tel. 0800 324 7005 ose na dërgoji një email te StartWellConsultation@ors.org.uk për të mësuar më shumë për konsultimin dhe mënyrat se si mund të na tregoni mendimet tuaja, si dhe për të përmbushur pyetësonin e konsultimit.

4.2 | Hapat e radhës

Pas mbylljes së konsultimit më dt. 17 Mars 2024, të gjitha reagimet që do të kemi marrë do të analizohen nga një organizatë kërkimore e pavarur. Ajo do të na hartojë një relacion i cili do të paraqesë mendimet e njerëzve për propozimet. Do t'i përdorim të gjitha reagimet, bashkë me prova dhe informacione të tjera, për të vendosur se si të ecim përpara.

Do të vazhdojmë të botojmë informacion lidhur me punën tonë, përfshi botimin e relacionit të konsultimit dhe dokumente kyç të cilat do ta informojnë vendimmarrjen, për personelin, pacientët dhe të interesuarit më gjerësisht. Takimi i fundit i vendimmarrjes do të zhvillohet me dyer të hapura ndaj publikut që t'i lejojë të interesuarit ta dëgjojnë diskutimin dhe mënyrën se si merret vendimit. Presim që vendimin ta marrim brenda vjeshtës/dimrit 2024/2025. Ju mund të mësoni më shumë për kronikun e vendimmarrjes në faqen tonë të internetit.



Internet: nclhealthandcare.org.uk/start-well
Email: StartWellConsultation@ors.org.uk
Postö: FREEPOST SS1018, PO Box 530, Swansea, SA1 1ZL
Telefon: 0800 324 7005